

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Në bastionet e ish-guerilëve kosovarë, vendimi i afërt gjyqësor nxit zemërim dhe mbështetje të fortë
ADRESA	https://www.reporter.al/2026/09/14/ne-bastionet-e-ish-guerileve-kosovare-vendimi-i-afert-gjyqesor-nxit-zemerim-dhe-mbeshtetje-te-forte/
BURIMI	reporter.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 10:46:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 1800 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 10:36:59 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8a0c325ef38a93ee97f7372ee37811b80b4b0f182a5c8319bf85711c98063fae
TEKSTI	ab409a8304fda7dcc902c93eb59c9985f8834d35544fb9837f7a6c27886126a3
PAMJA	1594e2ab8bda1668bb99783d41cddab7e35a6edd2d44b3c41f3a33137bfd02a0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1ba6420a247f38948ad9bd726653c8a1fdc2225e6daa10adc4f5368bbba13dd2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	fa5011856be057622e11e3b7b9503371417a521d23e6e858a13f19aee6db6a1d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1ba6420a247f38948ad9bd726653c8a1fdc2225e6daa10adc4f5368bbba13dd2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kryefaqja Rajoni

Në bastionet e ish-guerilëve kosovarë, vendimi i afërt gjyqësor nxit zemërim dhe mbështetje të fortë

Në zonat që dikur ishin bastione të UÇK-së, banorët shprehin zemërim dhe mbështetje të fortë, ndërsa pritet vendimi për katër ish-pjesëtarë të saj të gjykuar për krime lufte.

nga Serbeze Haxhijaj — 3 minutes më parë në Rajoni Koha e leximit: 6 min lexim

AA 0



Grafiti në mbështetje të të akuzuarve në Hagë. Foto: BIRN.

Milazim Thaçi mbijetoi i palënduar, i fshehur nën trupat e atyre që nuk mundën t'u shpëtonin plumbave.

Më 28 mars 1999, katër ditë pasi NATO-ja kishte nisur një fushatë ajrore për të larguar forcat serbe nga Kosova, ai ishte në mesin e një grupi prej 33 burrash që u dërguan për t'u ekzekutuar në luginën e Drenicës, bastionin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, UÇK-së.

Ai kujton se policët dhe ushtarët serbë i tallnin: "Ku është Thaçi? Ku është NATO-ja?"

Me "Thaçin" ata nënkuptonin Hashim Thaçin, një nga drejtuesit kryesorë të UÇK-së. Milazimi e njihte më mirë si kushëririn e tij më të ri, një djalosh i turpshëm dhe i gjatë, gjithmonë i respektueshëm ndaj më të mëdhenjve. "Ishte djalë që fliste pak", tha Milazimi për BIRN në shtëpinë e tij në Burojë, një fshat në komunën e Skënderajt.

Gjithsej, 146 shqiptarë u vranë më 28 mars në fshatin Izbicë, në një nga masakrat e fundit të një vargu mizorish masive të kryera nga forcat nën udhëheqjen e liderit serb Slobodan Millosheviç në atë që atëherë ishte provinca jugore e Serbisë. Milazimi u fsheh nën trupat e dy prej viktimave dhe mbijetoi.

Pesë ditë më vonë, ai mori vesh se kushëriri i tij ishte bërë kryeministër i një qeverie të përkohshme të vetëshpallur në Kosovë. Pas luftës, Thaçi hyri në politikë dhe u ngrit deri në postin e presidentit.

Megjithatë, këtë javë ai do të mësojë fatin e tij në përfundim të një gjyqi për krime lufte në Hagë, një proces që ka zemëruar ata që e shohin atë si hero.

Për njerëz si Milazimi 80-vjeçar, i cili e përjetoi nga afër brutalitetin e luftës kundër kryengritjes të zhvilluar nga Serbia, mundësia që Thaçi të shpallet fajtor për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit duket si një padrejtësi historike.

"Është e vështirë për ne", tha ai për BIRN-in mes lotësh. "Është edhe më keq për Kosovën."

Gjykata, e cilësuar me përcëpim si "krijesë politike"



Në bastionet e ish-guerilëve kosovarë, vendimi i afërt gjyqësor nxit zemërim dhe mbështetje të fortë

12:36 | 14/09/2026

Maqedonia e Veriut rishikon rregullat për "pasaportat e arta", por shqetësimet e BE-së mbeten

11:24 | 14/09/2026

Të rinjtë shfrytëzohen si vrasës me pagesë në "luftërat" e drogës në Ballkan

11:10 | 14/09/2026

I dërguari i Trump, me mision lobimi në Tiranë për rizgjedhjen e kreut të FIFA

06:54 | 14/09/2026

"Bed & Breakfast": Në Durrës, bizneset po heqin dorë nga numërimi i turistëve

07:47 | 13/09/2026

'PISA 2025': Pasqyra e deformuar e suksesit të qeverisë me arsimin

08:31 | 12/09/2026



Një flamur në mbështetje të Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit valëvitet mbi një shtëpi në Burojë, fshati i lindjes së Thaçit. Foto: BIRN.

Si student, Thaçi kishte protestuar kundër sundimit shtypës të Serbisë mbi Kosovën. Me një objektiv në shpinë, ai u arratis në Zvicër. Shqiptarët, megjithatë, po humbnin durimin me politikën e rezistencës paqësore të ndjekur pasi Millosheviçi i dha fund statusit autonom të krahinës në fund të viteve 1980. Thaçi u kthye për të luftuar dhe UÇK-ja doli nga malet dhe pyjet për të goditur forcat serbe të sigurisë.

"Shtypja dhe padrejtësia e çuan në luftë", tha Milazimi.

Lufta kulmoi me 11 javë sulme ajrore të NATO-s, të cilave Serbia iu përgjigj me një valë të re mizorish dhe spastrimi etnik, që detyroi qindra mijëra shqiptarë të kalonin kufirin drejt Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë.

Millosheviçi kapitulloi në qershor 1999; forcat serbe u tërhoqën dhe paqeruajtësit e NATO-s hynë në Kosovë. Po atë muaj, Milazimi u intervistua nga hetues të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, GJPNJ.

Në vitin 2002, Milazimi dëshmoi në gjyqin e Millosheviçit në Hagë dhe, shtatë vjet më vonë, dëshmoi sërish kundër ish-gjeneralëve të lartë të ushtrisë dhe policisë, Vlastimir Gjorgjeviq, Nebojsa Pavkoviq, Vladimir Lazareviq dhe Sreten Lukiq, të cilët më vonë u dënuan të gjithë. Millosheviçi vdiq në vitin 2006, para përfundimit të gjyqit të tij.

Thaçi, megjithatë, nuk po gjykohet nga GJPNJ-ja, por nga Dhomat e Specializuara të Kosovës, të krijuara nga Kosova në vitin 2015 nën presion të fortë perëndimor për të shqyrtuar akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit të kryera nga UÇK-ja gjatë dhe menjëherë pas luftës.

Thaçi u akuzua në vitin 2020, ndërsa ishte ende president, së bashku me tre ish-drejtuës të tjerë të UÇK-së. Që atëherë, ata kanë qëndruar në paraburgim në Hagë, mes akuzave të prokurorisë për kanosje të dëshmitarëve.

Mënyra se si po trajtohen thjesht e ka thelluar ndjenjën e padrejtësisë që shqiptarët e Kosovës kanë ndaj gjykatës.

"Është një tradhti, një mashtrim, një vrasje e dytë e viktimave tona", tha Milazimi.

"Nëse do të ishte gjykuar nga Kombet e Bashkuara, do të ishte më e pranueshme", tha ai për BIRN, duke iu referuar GJPNJ-së, e cila u krijua nën kujdesin e OKB-së. "Por kjo gjykatë është një krijesë politike, që e barazon viktimën me kriminelin."

Të përdorur si "koka turku"?



Milazim Thaçi. Foto: BIRN.

Në fshatin e Milazimit, në disa prej shtëpive valëvitën flamuj me portretin e Thaçit.

"Ne e dimë si u ritën këta njerëz, në varfëri dhe nën shtypje, dhe si luftuan për shtëpitë e tyre", tha 78-vjeçari Sinan Shala. "Ngritja e aktakuzës ndaj tyre ishte si të vrisje për herë të dytë katër anëtarë të familjes sime."

Të njëjtat ndjenja dëgjohej edhe në Negrovç, në komunën e Drenasit, ku u rrit Jakup Krasniqi, zëdhënës i UÇK-së dhe një nga të akuzuarit bashkë me Thaçin.

"Ai ka qenë gjithmonë i përndjekur", tha vëllai i tij, Abdyl. "Ai kaloi 10 vjet si i burgosur politik në Serbi."

Krasniqi, i diplomuar për histori, u burgos në vitet 1980 për pjesëmarrje në protesta ku kërkoheshin të drejta të barabarta për Kosovën brenda ish-Jugosllavisë.

"Duke e ditur se sa shumë tortura kishte përjetuar, të qenit në këtë burg në Hagë ishte edhe më e vështirë se çdo gjë tjetër", tha Abdyl për vëllain e tij 75-vjeçar. "Jakupi dhe të tjerët duhej të shërbenin si koka turku për diçka që nuk ka aspak lidhje me drejtësinë."

Në vendin ku lindi Krasniqi, shtëpitë e vjetra që u shkatërruan gjatë luftës janë rindërtuar, por njëra prej tyre ende qëndron, me muret e shenjuara nga vrimat e plumbave.

Këtu, njerëzit besojnë se gjyqi ndaj Krasniqit, Thaçit, Rexhep Selimit dhe Kadri Veselit është pjesë e një pazari politik të imponuar nga fuqitë e mëdha, një lëshim ndaj Serbisë në kurriz të Kosovës.

"Ai nuk ka qenë kurrë i aftë të kryente një krim", tha kushëriri i Krasniqit, Qamili.

Pranë shtëpive të familjes Krasniqi ndodhet një varrezë ku janë varrosur viktimat e luftës.

"Ne u rritëm duke parë këto varre", tha nipi i Krasniqit, Eritoni. "Nuk do ta harrojmë kurrë atë që ndodhi."

"Mosbesim dhe pakënaqësi"



Abdyl Krasniqi. Foto: BIRN.

Pak gjëra kanë mbetur nga Aqareva, vendlindja e Rexhep Selimit, 55 vjeç.

Ky fshat në luginën e Drenicës është kryesisht i braktisur; kanë mbetur vetëm disa çifte të moshuara, që jetojnë me plagët e mbetura nga luftërat.

Ish-fqinji 86-vjeçar i Selimit, Sadik Bajrami, e kujton atë si një djalë të gjallë e energjik. Selimi u shpërngul me familjen në Klinë, por Bajrami kujton se ai u kthye si luftëtar në vitin 1998.

"Rexha ishte shumë i kujdesshëm që ushtarët e UÇK-së të mos shkelnin rregullat", tha Bajrami. "Ai ishte strikt."

Selimi, i diplomuar për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe në Universitetin e Prishtinës, thuhet se ka shërbyer si Inspektor i Përgjithshëm i UÇK-së dhe më pas si ministër i Brendshëm në qeverinë e përkohshme të vetëshpallur nën Thaçin.

Bajrami, i cili humbi këmbën e djathtë nga një granatë e hedhur nga forcat serbe, tha se asgjë nga ato që kishte parë gjatë gjyqit në Hagë nuk e kishte bindur se të akuzuarit ishin përgjegjës për krimet e pretenduara, apo se kishin pasur dijeni për to.

Gjykata, tha ai, "nuk ka asnjë lidhje me synimin për të vendosur drejtësinë".

Në anën tjetër të fshatit, 78-vjeçari Bajram Azemi tha se seancat e shpeshta me dyer të mbyllura – për mbrojtjen e dëshmitarëve – e kishin lënë konfuz dhe të pabindur.

"Kam parë shumë trupa të shqyer nga granatat këtu", tha Azemi. "Nëse këta katër burra do të shpalleshin fajtorë, ky do të ishte një krim. Nuk do të ishte drejtësi. Do të ishte një krim."

Po kështu, në Broboniq, ku u rrit 59-vjeçari Kadri Veseli, banorët e kujtojnë atë me dashuri.

"Unë e di vuajtjen e tij", tha 43-vjeçari Sherif Haziri. "Po pres që ai të dalë. Nuk mund ta pranoi dënim që kishte atë u ka shkelatur shpirt."

pranë vendimit që një gjykatë u nënshkruan tregë.

Veseli thuhet se ka qenë në krye të inteligjencës së UÇK-së dhe më vonë u bë drejtor i Shërbimit Informativ të Kosovës.

Emri i tij është shkarravitur në muret në të gjithë fshatin. Një i afërm, Arsimi, tha se nuk do ta pranonte kurrë një vendim fajësie.

"Kriminalizimi i luftës çlirimtare ka mbjellë një ndjenjë të fortë mosbesimi dhe pakënaqësie", tha ai për BIRN. "Askush në Kosovë nuk do ta njohë këtë gjykatë apo ta pranojë vendimin e saj nëse ata shpallen fajtorë."

Etiketa: Dhomat e Specializuara Gjykata Speciale e Kosovës Hashim Thaçi Jakup Krasniqi kadri veseli Kosova krime lufte Rexhep Selimi Serbia UCK

Reporter.al

Opinion
Reportazhe
Analiza
Investigime
Lajme
Blog
Rajoni

Rreth nesh
Stafi
Kontakti
Ankesa dhe Korrigjime
Politika e privatësisë dhe rregulla të tjera
Letra për redaktorin

Follow Us



Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.
© 2014 - 2026 Reporter.al - BIRN
Dev by Slida.PRO

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.